



Buletin informativ





PËRMBAJTJA:

TITULLI	FAQE
Fjala e Komandantit të Gardës Gjeneral Gramos SAKO	3
Listë Shkurtimesh.....	5
Hyrje	6
Kapitulli I.....	8
Kapitulli II.....	11
Kapitulli III.....	28
Kapitulli IV.....	30
Kapitulli V.....	34



FJALA E KOMANDANTIT TË GARDËS GJENERAL GRAMOS SAKO

Në përmbyllje të vitit 2020, Gardë e Republikës synon të ekzaminojë në detaje veprimtarinë e kryer gjatë 365 ditëve të punës së institucionit, sikurse studimin e realizimit të objektivave dhe prioriteteve të paravendosura në krye të vitit.

Veprimtaria e Gardës së Republikës së Shqipërisë gjatë vitit 2020, ka qënë në rrethana krejtësisht të ndryshme nga ato të vitit 2019. Sfida kryesore për institucionin dhe jo vetëm, që prej shpërthimit të pandemisë globale si pasojë e Covid 19, ishte përshtatja me realitetin e ri për shërbimet, të cilat duhet thënë që pikërisht në sajë të situatës së krijuar prej virusit, do të mbartnin një rëndësi më të lartë.

Prioriteti kryesor për vitin që u mbyll ka qënë përmbushja e misionit të Gardës. Më gjerësisht përfshihet; siguria e jetës së personaliteteve, e objekteve dhe mjediseve të punës, të banimit, të akomodimit, sigurisë së rrugëkalimeve, siguria e personaliteteve në mjedise të hapura e të mbyllura me qëllim që të parandalohet në kohë jo vetëm çdo akt i mundshëm me tendencë kriminale, por edhe çdo veprim tjetër sado i dhunshëm apo pengues në lëvizjen normale dhe ushtrimin e detyrës së personalitetit.

Të bësh bilancin e punës së vitit që lamë pas, padyshim është një çështje që kërkon vëmendjen e duhur për të analizuar të gjithë komponentët përbërës të punës sonë, me treguesit pozitivë, por edhe problematikat e hasura. Ky raport pasqyron në mënyrë të përmbledhur këta tregues për secilën strukturë përbërëse të saj, e cila ka specifika të vetat në detyrat që kryen.

Arritjet dhe problematikat e konstatuara gjatë punës pasqyrojnë sfidat me të cilat jemi përballur. Gjatë vitit 2020, të gjithë punonjësit e Gardës kanë treguar përkushtim profesional dhe efikasitet të plotë në përmbushje të misionit, por njëkohësisht edhe të prioriteteve të vendosura nga institucioni epror, Ministria e Brendshme. Në punën tonë ne mbështetemi në zbatimin e plotë të ligjit aktual “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, prioritetet e programit të Qeverisë Shqiptare, të Ministrisë së Brendshme, Urdhrat, Udhëzimet e Ministrisë së Brendshme, programin e vetë institucionit dhe ngjarje të papritura të ndodhura gjatë vitit. Për të patur sukses është shumë i rëndësishëm organizimi i punës dhe shpërndarja e saj.



Përpos kryerjes së misionit dhe zbatimit me përpikmëri të ligjit, qëllim për ne përbën edhe përfaqësimi sa më natyrshëm, real dhe me dinjitet i punonjësit të këtij shërbimi në komunitet si pjesë përbërëse e tij, krijimi i emrit të respektuar të Institucionit si pjesë e administratës shtetërore dhe përfaqësimi dinjitoz i imazhit të Shqipërisë tek Personalitetet e Huaja.

Duke qenë se misioni i Gardës dhe vetë objekti i punës lidhen ngushtësisht me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje, edhe raporti i punës së Institucionit fillon me cilësinë e përmbushjes së këtyre detyrave që rrjedhin nga misioni i përgjithshëm.

Në faqet e këtij raporti pasqyrohet një përshkrim i detajuar i punës së Gardës së Republikës gjatë vitit 2020.

Garda synon të krijojë një raport të hapur komunikimi edhe me publikun. Për këtë arsye, në kapitullin përkatës janë pasqyruar objektivat e zhvillimit të Gardës së Republikës, të cilat do të orientojnë punën tonë për vitin 2021 dhe do të jenë të publikuara në faqen e internetit të institucionit.

Viti 2020 do të mbahet mend gjatë në kujtesën tonë. Situata e pandemisë solli fatkeqësisht humbje jete edhe në radhët e punonjësve të Gardës.

Duke përfituar nga rasti, në emër edhe të Gardës së Republikës – shpreh ngushëllimet më të sinqerta për familjarët e punonjësve që humbën njerëzit e dashur.

Në mbyllje, dëshiroj t'ju siguroj se Garda e Republikës së Shqipërisë do vijojë të përmbushë misionin e ngarkuar prej ligjit dhe komform tij, në mënyrën më cilësore të mundshme.

Gjeneral Gramos SAKO
Komandant i Gardës së Republikës



LISTË SHKURTIMESH

Ministria e Brendshme	MB
Garda e Republikës së Shqipërisë	GRSH
Drejtoria e Planifikimit, Koordinimit dhe Kontrollit	DPKK
Drejtoria për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore	DSPLSH
Drejtoria për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë	DSOD
Qendra e Formimit dhe Kualifikimit Profesional	QFKP
Personalitete të larta shtetërore	PLSH
Personalitete shtetërore	PSH
Objekte të Rëndësisë së Veçantë	ORV
Objekte të përkohshme	OP
Policia e Shtetit	PSH
Shërbimi informativ shtetëror	SHISH
Akademia e Sigurisë	AS
Struktura e Posaçme Antikorrupsion	SPAK
Byroja Kombëtare e Hetimit	BKH
Inspektori i Lartë i Drejtësisë	ILD
Raporti i vlerësimit të ndikimit	RIA
Komisioni i pavarur i apelimit	KPA
Komisioni i pavarur i kualifikimit	KPK
Operacioni ndërkombëtar i monitorimit	ONM
Objekt i Kohës së Veçantë	OKV
Armë të shkatërrimit në masë	ASHM
Lëndë eksplozive	LE
Instituti i Shëndetit Publik	ISHP



HYRJE

Garda e Republikës u krijua në 24 Qershor 1928. Ajo funksionon në bazë të Ligjit nr. 8869, datë 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Garda e Republikës së Shqipërisë është institucion i sigurisë kombëtare, me status të veçantë, në varësi të Ministrit të Brendshëm.

Misioni i Gardës është ruajtja dhe mbrojtja e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe të Rezi-dencave, të përcaktuara në ligj. Ky mision nuk ndryshon në gjendje të jashtëzakonshme apo në gjendje lufte.

Punonjësit e GRSH gëzojnë status të veçantë sipas ligjit.

Rregullimi i veprimtarisë së institucionit dhe punonjësve pasqyrohet në Rregulloren e Brendshme e cila është një akt nënligjor që bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë, Ligjin Nr. 8869 datë 22.05.2003 “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin Nr. 9445 datë 16.11.2005. Ajo është dokumenti bazë në të cilën trajtohen rregullat e punës e të shërbimit në Gardën e Republikës dhe është e detyrueshme për t’u zbatuar nga të gjithë nivelet e punonjësve të Gardës.

Në këtë Rregullore, përcaktohen: organizimi dhe përbërja e Gardës, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave. Përcaktohen rregullat e organizimit, planizimit, kryerjes së shërbimit të sigurisë për ruajtjen dhe mbrojtjen e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe ORV.

Zbatimi i kërkesave të kësaj rregulloreje krijon kushte për veprime të harmonizuara e standarte të personelit të Gardës.

Në zbatim të kësaj Rregulloreje, drejtuesit hartojnë detyrat funksionale për të gjitha nivelet. Po ashtu, me synim rregullimin e veprimtarisë së Gardës dhe Ligjshmërinë e saj,

janë miratuar një sërë aktesh nënligjore siç janë: Rregullorja e personelit në Gardën e Republikës, Rregullorja e disiplinës në Gardën e Republikës, VKM në lidhje me ruajtjen dhe mbrojtjen e PLSH, PSH dhe ORV, etj.

Në zbatim të detyrave të reja që iu ngarkuan, Garda e Republikës propozoi organikën e re të funksionimit të saj, e cila u miratua me VKM nr. 572, datë 22.07.2020.

Sipas kësaj organike, Gardës i janë shtuar në përgjegjësi për ruajtje e mbrojtje organet e reja të drejtësisë: SPAK, BKH dhe ILD.

Konceptimi dhe projektimi i këtyre akteve është bërë mbi bazën e 6 shtyllave kryesore, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e objektivave të realizuara në zbatim të prioriteteve të Ministrisë së Brendshme, realizimin e objektivave të vendosura nga GRSH për vitin 2020, treguesit e punës krahasuar me një vit më parë, akte të miratuara si dhe objektiva të vendosura për vitin 2021.

Garda e Republikës në sajë të një metodologjie pune të hartuar më parë, ka përpunuar dhe analizuar të dhëna cilësore dhe sasiore mbi punën e kryer deri më tani nga strukturat e institucionit.





KAPITULLI I

OBJEKTIVA TË REALIZUARA

1. NË ZBATIM TË PRIORITETEVE TË MINISTRISË SË BRENDSHME PËR VITIN 2020

Si çdo fillim viti, organi epror i Gardës së Republikës, Ministria e Brendshme, harton dhe miraton prioritetet e saj për strukturat e varësisë së bashku me planin e masave.

Konkretisht - në projektet e infrastrukturës dhe pajisjeve teknike parashikohet:

Në fokusin kryesor të Ministrisë së Brendshme për vitin 2020 në fushën e projekteve ishte modernizimi i strukturave me projekte infrastrukturore të rikonstruksionit, ndërtimit të godinave të reja apo riorganizimit të atyre ekzistuese. Në fushën e infrastrukturës puna u përqëndrua në hartimin e projekteve studimore të zhvillimit infrastrukturor dhe ato për infrastrukturën digjitale.

Objektivi i miratimit të Ligjit “Për Gardën e Republikës”, “Përmirësimi ligjor, organizativ dhe operacional në e reformimit të GRSH”.

Në kuadër të përmbushjes së këtij prioriteti, për hartimin e projektligjit, u ngrit grupi i punës bazuar në Urdhrin e Ministrit të Brend shëm nr. 295 datë 08.09.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për Gardën e Republikës” dhe pati gjithashtu takime me përfaqësues të Policisë së Shtetit dhe ekspertë të Pameca V. Pas takimeve të zhvilluara nga grupi i punës për këtë qëllim dhe pas sugjerimeve të Ministrisë së Financave, DAP, Ministrisë së Drejtësisë dhe Kryeministrisë, u hartua drafti i projektligjit, i cili reflektonte të gjitha këto sugjerime. Pas fillimit të konsultimit publik mbi këtë projektligj, u hartua nga Garda, relacioni përkatës dhe RIA (raporti i vlerësimit të ndikimit). Këto materiale u dërguan në kohë dhe brenda afateve të përcaktuara, në MB.



Programi i kualifikimit dhe trajnimit të punonjësve.

Trajnimi i përgjithshëm profesional për detyrën që kryen secili, përvetësimi apo perfeksionimi i njohurive në gjuhën angleze e të tjera të huaja, si dhe sporti, kanë qenë elementët bazë të programeve të trajnimit dhe kualifikimit. Gjatë kësaj periudhe po ndiqet dhe monitorohet progresi i bërë nga personeli në përmirësimin e kondicionit fizik dhe njohurive të mësimin të gjuhës angleze.

Për përmbushjen e këtij prioriteti, gjatë vitit 2020, u kryen kurset për përparimin në gradë e karrierë të punonjësve që u lindi e drejta për të konkuruar për gradën pasardhëse. Për shkak të kushteve të pandemisë, këto kurse u zhvilluan të kombinuara me sistemin online. Ndër kriteret që u vlerësuan gjatë fazave të testimit ishte edhe njohuria e secilit punonjës kandidat për gradë, për gjuhën e huaj angleze, duke vlerësuar secilin prej tyre në bazë të sistemit të pikëzimit.

Trajnimi i niveleve të larta drejtuese u bë në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë.

2. NË ZBATIM TË PRIORITETEVE TË GARDËS PËR VITIN 2020

Çdo fillim viti, Garda e Republikës, krahas objektivave dhe prioriteteve të vendosura nga Ministria e Brendshme për zbatim, vendos objektiva për vetë institucionin, mbi bazën e së cilave zhvillohet veprimtaria, përmirësohen treguesit e punës dhe hartohen planet e punës.

Ndër objektivat kryesore strategjike të vendosura për vitin 2020 nga Garda për strukturat ka qenë:

- përmirësimi i nivelit të sigurisë së PLSH, PSH dhe ORV.
- përmirësimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor të Gardës.
- përmirësimi i procesit të menaxhimit në Gardën e Republikës.
- përmirësimi i performancës në strukturat operationale dhe ato mbështetëse.
- përmirësimi i programeve të kualifikimit dhe trajnimit.



Për realizimin e këtyre objektivave Garda ka zhvilluar punën e saj në dy drejtime kryesore:

1. Në përmirësimin e stërvitjes, kualifikimeve dhe trajnimeve.
2. Në hartimin e kuadrit ligjor që krijon arkitekturën e ligjshmërisë së institucionit.

Me gjithë vështirësitë që krijoi pandemia e shkaktuar nga Covid 19, mund të themi se GRSH ka arritur të përmbushë objektivat e paravendosura në mënyrë të kënaqshme.

Sa i përket shërbimeve të sigurisë, të cilat përbëjnë thelbin e misionit të institucionit, ato janë realizuar në mënyrë cilësore.

Një rol tepër domethënës në drejtim të përmirësimit të kushteve të punës dhe trajtimit të punonjësve, me qëllim motivimin e tyre për të rritur cilësinë e shërbimeve, e po ashtu për të vlerësuar punën e tyre të palodhshme, Qeveria Shqiptare miratoi VKM si më poshtë:

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 551, datë 15.07.2020 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit oficerë e nënoficerë të Gardës së Republikës" e ndryshuar me VKM nr. 640, datë 29.07.2020
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 638 datë 29.07.2020 "Për trajtimin me ushqim të punonjësve dhe kursantëve të Gardës së Republikës", duke bërë që nëpërmjet furnizimit ose kompensimit të ushqimit, të bëhet një përmirësim i ndjeshëm i trajtimit të efektivit e për rrjedhojë dhe rritjen e performancës së shërbimeve tona.
3. Miratimi i VKM nr. 639 datë 29.07.2020 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve oficerë dhe nënoficerë të Gardës së Republikës së Shqipërisë", çdo punonjës Garde përfiton një rritje në pagë në masën 1% për çdo vit pune. Deri në vitin 2020 pagat e punonjësve janë rritur me rreth 13%.

KAPITULLI II

TREGUESIT E PUNËS SË VITIT 2020

Misioni i Gardës dhe vetë objekti i punës lidhen ngushtësisht me sigurinë e personaliteteve dhe objekteve në ruajtje. Edhe ky buletin i institucionit fillon me cilësinë e përmbushjes së këtyre detyrave që rrjedhin nga misioni i përgjithshëm.

Viti 2020 ka patur të veçantat e veta në aspektin e objektivave e prioriteteve, për ngarkesën e konsiderueshme që e ka karakterizuar dhe performancën cilësore të realizimit të shërbimeve, veçanërisht të atyre të kryera mbi kohën normale të punës e mbi të gjitha të zhvilluara në kushtet e pandemisë.

Krahas shërbimeve të përhershme për sigurinë e PLSH, PSH, ORV dhe objekteve të Infrastrukturës së Gardës së Republikës, mund të veçojmë:

- Shërbimet e përforcuara të kryera për sigurinë e PLSH dhe ORV gjatë zhvillimit të protestave.
- Marrjen e masave të sigurisë për ruajtjen dhe mbrojtjen e personaliteteve të huaja që vizituan vendin tonë.
- Marrjen e masave të sigurisë për ruajtjen dhe mbrojtjen e delegacioneve të huaja që vizituan vendin tonë ku veçojmë:
 - Ministerialin e zhvilluar në Tiranë me pjesëmarrjen e disa Ministrave të Turizmit dhe Mjedisit të Rajonit;
 - Ministerialin e zhvilluar në Tiranë me pjesëmarrjen e disa Ministrave të Ekonomisë e Financave të Rajonit;
 - Takimin G2 midis qeverive të Kosovës dhe Shqipërisë që u zhvillua në Tiranë, e të tjera.





VËMENDJA GJATË VITIT U PËRQËNDRUA NË KËTO DREJTIME:

- Përmbushja e misionit për ruajtjen, sigurinë dhe mbrojtjen e PLSH, PSH, ORV.
- Zbatimi i objektivave të parashikuara në Prioritetet e vitit 2020 të Ministrisë së Brendshme dhe në planet e punës të strukturave për sigurinë e PLSH të vendit dhe të huaja dhe ORV-ve.
- Planifikimi i detyrave në Gardë dhe struktura për vitin 2020 për sigurinë, ruajtjen dhe mbrojtjen e PLSH, PSH, ORV dhe objekteve të infrastrukturës së Gardës.
- Trajnimi dhe kualifikimi i personelit të strukturave të Gardës.
- Sigurimi i mbështetjes së nevojshme të strukturave të Gardës me personel, Logjistikë, mjete e pajisje teknike, shërbime e specialistë të fushës për realizimin e detyrave të vitit 2020.
- Hartimi dhe dorëzimi i projektligjit “Për Gardën e Republikës” së bashku me Relacionin dhe RIA.

TË VEÇANTA TË VITIT 2020 SIPAS MUAJVE:

- Janar – Zhvillimi i analizës së punës së veprimtarive kryesore të Institucionit për vitin 2019. Risi ishte zhvillimi i kursit trajnues me oficerët që do të drejtojnë përgatitjen për qitje gjatë vitit me punonjësit nënoficer. Garda u falënderua nga Ambasada e Republikës së Maqedonisë së Veriut për shërbimet profesionale të sigurisë dhe përkushtimin e treguar gjatë vizitave të zyrtarëve të lartë maqedonas në vendin tonë.
- Shkurt – Trajnimi i 22 punonjësve në kursin e mbrojtjes VIP, në Republikën e Turqisë.
- Mars – U hartua plani i masave në zbatim të Vendimeve të Këshillit të Ministrave për parandalimin e përhapjes së COVID-19, Urdhrave dhe Udhëzimeve të Ministrit të Brendshëm. Në këtë plan u parashikuan detyrat e strukturave të Gardës për situatën e krijuar.
U zhvilluan kurset për përparim në gradë dhe karrierë për oficerët dhe nënoficerët, të cilat u zhvilluan në sistemin online për shkak të pandemisë.



Në kuadër të parandalimit të përhapjes së virusit Covid 19, u bë dezinfektim i herëpashershëm i të gjitha automjeteve të përdorura për sigurimin e PLSH-ve, PSH-ve dhe të automjeteve të përdorura për transportin e punonjësve, sikurse i ambienteve të punës dhe shërbimit të Gardës, për të garantuar sigurinë e shëndetit të secilit.

U siguruan personalitetet e huaja që vizituan vendin tonë si: Presidenti i Republikës së Bullgarisë, Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryetari i Këshillit Kombëtar të Republikës së Austrisë, pjesëmarrësit në Ministerialin e Ministrave të Punëve të Jashtme të rajonit.

- Prill – Në kuadër të fushatës sensibilizuese, dhuruan gjak në Bankën e Gjakut për njerëzit në nevojë dhe fëmijët talasemikë, 113 punonjës të Gardës.
U sigurua Ministri i Jashtëm i Hungarisë gjatë vizitës së tij në vendin tonë.

- Maj – U morën masa sigurie me shërbime të përforcuara për ruajtjen dhe mbrojtjen e PLSH-ve dhe ORV-ve, shkak i protestave të shoqërisë civile dhe subjekteve politike.

- Qershor – Në kuadër të plotësimit të vendeve vakante për punonjës Oficer dhe Nënoficer në strukturat e Gardës, u kryen procedurat e konkurimit për të dyja kategoritë e punonjësve. Testimi fizik dhe intervista u kryen konform përcaktimeve të shpallura edhe në njoftimet e faqes zyrtare të institucionit.

- Korrik – Përfundoi punën Komisioni i Gradave dhe Karrierës për vlerësimin e punonjësve oficerë.


Në zbatim të VKM nr. 572 datë 22.07.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 445 datë 22.05.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës, të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, filloi puna për implementimin dhe shtrirjen organike të strukturës së re.

- Gusht – Takim i Ministrit të Brendshëm me drejtuesit e GRSH. Fokusi i kësaj vizite ishte vëmendja që iu dha Gardës pas miratimit të 3 VKM, të cilat vlerësuan financiarisht punonjësit për punën e palodhur që ata kryejnë në përmbushje të misionit të institucionit.

Në zbatim të VKM nr. 430 datë 03.06.2020 “Për disa ndryshime në VKM nr. 445 datë 22.05.2017”, përfundoi puna për shtrirjen organike në Gardë.

- Shtator – Në zbatim të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm nr. 296 datë 08.09.2020 përfundoi hartimi i strategjisë së Gardës së Republikës.
- Tetor – Në zbatim të Urdhrit nr. 7712 datë 26.10.2020 të Ministrit të Brendshëm “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit dhe përzgjedhjes së kandidatëve për ndjekjen e studimeve në Akademinë e xhandarmërisë dhe rojës bregdetare turke, me qëllim rekrutimin e tyre si oficerë dhe nënoficerë të Gardës së Republikës”, u shpallën në faqen zyrtare njoftimet përkatëse dhe gjatë muajit Nëntor vijoi procedura e konkurimit të kandidatëve të interesuar.
Në zbatim të Vendimit nr. 638 datë 29.07.2020 “Për trajtimin me ushqim pa pagesë të punonjësve dhe kursantëve të Gardës së Republikës” u përgatit, praktika e miratimit të normave ushqimore dhe u dërgua në Ministrinë e Brendshme.
Në zbatim të porosive të Ministrit të Brendshëm mbi hartimin e projektligjit “Për Gardën e Republikës” u ngrit grupi i punës për hartimin e tij.
- Nëntor – U siguruan të gjithë PLSH-të dhe PSH-të pjesëmarrëse gjatë zhvillimit të aktiviteteve në Vlorë dhe tek Varrezat e Dëshmorëve në Tiranë, me rastin e festave të 28 – 29 Nëntorit.
- Dhjetor – U zhvilluan analizat vjetore nga secila strukturë e Gardës së Republikës. U punua për përfundimin e draftit të projektligjit “Për Gardën e Republikës” së bashku me relacionin sqarues. Në zbatim të detyrës së lënë nga MB për dorëzimin e dokumentacionit shpjegues të projektligjit “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, dorëzuam RIA-n dhe Position Paper.





TREGUESIT E PUNËS SË GRSH GJATË VITIT 2020 SIPAS STRUKTURAVE

1.1. SHËRBIMET OPERACIONALE

Drejtoria e Planifikimit, Koordimit dhe Kontrollit, me sektorët e saj, mbart peshën kryesore në realizimin e detyrave

që lidhen me koordinimin, planifikimin dhe kontrollin. Kjo Drejtori gjatë vitit 2020 ka përgatitur në kohë dokumentet për planifikimin e përgjithshëm dhe atë të veçantë. Po ashtu, ka organizuar dhe ndjekur çdo veprimtari për koordinimin dhe bashkëveprimin në aktivitete të rëndësishme ndërmjet strukturave brenda dhe jashtë institucionit, si dhe monitoruar në terren zbatimin e planeve operacionale.

Për këtë vit, kjo Drejtori realizoi në kohë dhe me cilësi detyrat e programuara në “Planin e Veprimtarive Kryesore të Gardës së Republikës për vitin 2020”.

Kështu, gjatë këtij viti u përgatitën:

- Plani i veprimtarive kryesore të Gardës për vitin 2020.
- Udhëzimet për njohjen dhe zbatimin e “Planit të veprimtarive kryesore të Gardës për vitin 2020”
- Manuali i rregullave të sigurisë dhe ushtrimeve të qitjes për personelin e Gardës.
- U ripunua Manuali i përshkrimit të detyrave funksionale sipas fushës së përgjegjësisë.
- U ripunuan procedurat standarde të punës sipas funksioneve dhe fushës së përgjegjësisë.
- U ripunuan, rifreskuan dokumentat e planëzimit, të shërbimit, instruksionet dhe skemat e ruajtjes dhe mbrojtjes së PLSH-ve, ORV-ve dhe objekteve të infrastrukturës së Gardës.
- Janë përgatitur dhe ndjekur shërbimet e PLSH-ve, delegacioneve të huaja, me praktika të plota, si: konsulta, brifingje, përgatitje e urdhërave operacionale, monitorim të shërbimeve, organizim të bashkëveprimit midis strukturave të Gardës dhe koordinim me strukturat jashtë institucionit, duke mundësuar shërbime cilësore.

- Janë kryer kontrole nga ana e drejtuesve të Gardës në të gjitha strukturat, ku nga kontrollet e kryera nuk ka patur shkelje të rregullave të shërbimit. Për problemet e konstatuara dhe evidentuar gjatë kontrolleve, janë lënë detyra nga drejtuesit për t'u eliminuar dhe përmirësuar situatën.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 430 datë 03.06.2020 “Për miratimin e strukturës e të limitit organik dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese për çdo gradë në Gardën e Republikës së Shqipërisë”, që prej datës 01.08.2020, DPKK i janë shtuar funksionet: Specialist për Sigurinë dhe Koordinimin, Specialistët për Shërbimet, Specialisti për Formimin dhe Trajnimet, Specialisti për Qarkullimin Rrugor, Specialisti për Botimet dhe Statistikat, si dhe funksioni më i ri që iu shtua GRSH që është ai i Psikologut.

Janë hartuar statistikat e shërbimeve dhe treguesve të tjerë të veprimtarisë së strukturave të Gardës. Janë përgatitur informacione dhe analiza statistikore të shërbimeve, me qëllim nxjerrjen e përfundimeve për të përmirësuar punën e drejtuesve të strukturave të Gardës.

Është punuar nga psikologu për njohjen dhe evidentimin e veçorive individuale të personalitetit të punonjësve të Gardës, si dhe është bashkëpunuar me drejtuesit e strukturave, për marrjen në kohë të masave, në lehtësimin e faktorëve që veprojnë negativisht në individë të veçantë apo grup individësh si dhe për punonjësit që mund të kenë nevojë për ndihmë apo këshillim. Është drejtuar e menaxhuar procesi i testimit psikologjik të aplikantëve, kandidatë për punonjës të Gardës së Republikës. Më konkretisht, është kryer vlerësimi psikologjik për oficerë dhe nënoficerë për praninë në strukturat e Gardës. Për gjithësecilin është përpiluar raport – vlerësim i posaçëm, në interes të Sektorit të Burimeve Njerëzore. Janë zhvilluar tema në QFKP për efektet psikologjike nën stres të shërbimeve në Gardën e Republikës dhe mënyrën e përballimit të tyre.

Duke qenë se shërbimi psikologjik është vendosur rishtaz në GRSH, gjatë këtij viti është vendosur kontakt me psikologët e DVP Tiranë, Durrës dhe repartit RENE A, për bashkëpunim dhe shkëmbim përvojash.

Partneriteti me institucionet e tjera në Gardë është i domosdoshëm dhe fillon që me marrjen e informacionit deri në transmetimin e tij.



Rol kyç në këtë proces luan **Salla Operative**. Për këtë vit, ky sektor ka realizuar marrjen e urdhrave, porosive e detyra për zbatim, të cilat janë ndjekur me përgjegjësi dhe zbatuar pa asnjë problem në harkun kohor 12 mujor.

Drejtoria për Sigurinë e Personaliteteve të Larta Shtetërore, përgjigjet për sigurinë fizike të PLSH-ve dhe familjeve të tyre, të PSH-ve, të sigurisë së banesave të PSH-ve, sigurinë e ambienteve të brendshme të objekteve të përkohshme, kryerjen e eskortimit me motoçikleta ceremoniale për PLSH e vendit dhe të huaja, si dhe për përforcimin e masave të sigurisë pranë PLSH, PSH dhe ORV në rastet e përshkallëzimit të situatave.

Masat planëzuese, organizuese dhe drejtuese për sigurinë e PLSH, PSH të vendit e të huaja janë marrë në kohë e me korrektësi në mbështetje të urdhrave, udhëzimeve dhe situatave ku kanë zhvilluar aktivitete PLSH-të e PSH-të e vendit e të huaja.

DSPLSH gjatë vitit 2020 ka planifikuar, planizuar dhe realizuar detyrat e ngarkuara.

Nga Sektorët për Sigurinë fizike të PLSH-ve dhe PSH-ve janë marrë masa dhe kryer shërbime për sigurinë e Tyre në aktivitete të zhvilluara në Tiranë dhe ato jashtë saj.

Gjatë kryerjes së detyrave të shërbimit nuk janë konstatuar raste të shkeljes së rregullave të shërbimit apo cënim të masave të sigurisë së PLSH-ve e PSH-ve.

Sektori i Ruajtjes së Banesave ka vijuar detyrat rutinë normalisht.



**Drejtoria për Sigurinë e Organeve të Drejtësisë:**

Përgjigjet për ruajtjen, mbrojtjen, sigurinë e Anëtarëve të Vetingut, Prokurorit të Përgjithshëm, Drejtuesve të SPAK, Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, Kryetarin e Gjykatës së Lartë, Kryetarin e Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ish Prokurorin e Përgjithshëm,

godinat e KPA, ONM, KPK dhe godinën e Prokurorisë së Përgjithshme si dhe për organizimin e masave të sigurisë në sallat e zhvillimit të seancave dëgjimore.

Gjatë kryerjes së detyrave të shërbimit nuk janë konstatuar raste të shkeljes së rregullave të shërbimit apo cënim të masave të sigurisë së PLSH-së

Njësia e Parë i kushton vëmendje të veçantë organizimit, planëzimit dhe kryerjes me korrektësi dhe profesionalizëm të shërbimeve për sigurimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e Presidentit të Republikës në të gjitha aktivitetet në Tiranë e rrethe, si dhe PLSH-ve e PSH-ve të vendit dhe të huaja. Në drejtim të përmirësimit të disiplinës janë ushtruar kontrolle gjatë të kryerjes së detyrave të shërbimit.

Në Selinë e Presidencës janë organizuar masa shërbimi për Ambasadorët e vendeve të Huaja në Tiranë, dekorime, intervista, konferenca shtypi, Delegacione të ndryshme, Letra Kredenciale, vizitorë për punë e aktivitete të ndryshme, gazetarë dhe operatorë etj.

Njësia e Dytë ka për detyrë ruajtjen e mbrojtjen e Kryeministrit në Tiranë e në rrethe.

Kjo njësi ka kryer detyra shërbimi në Tiranë dhe rrethe, shërbime përforcimi në ORV gjatë aktiviteteve e pritjeve ceremoniale, për protestat e zhvilluara pranë selive shtetërore, sigurim të rrugëkalimeve në Tiranë.

Gjatë kryerjes së detyrave të shërbimit nuk janë konstatuar raste të shkeljes së rregullave të shërbimit apo cënim të masave të sigurisë së PLSH-së.

Njësia e Tretë në përmbushje të misionit të saj ka kryer shërbime në qytetin e Tiranës dhe në rrethe. Janë kryer shërbime të përforcuara për gatishmërinë.

Përveç shërbimeve të përhershme, Njësia e tretë organizon, planizon dhe kryen shërbime të përkohshme si:

- Shërbime për sigurim rrugëkalimi për PLSH-të e vendit dhe të huaja.
- Sigurime të aktiviteteve që ka zhvilluar Kryetari i Kuvendit.
- Përforcime shërbimi në Parlament për seanca plenare.
- Përforcime shërbimi në Pallatin e Brigadave me PLSH.
- Shërbime ceremoniale për PLSH-të e vendit dhe të huaja.
- Shërbime përforcimi për aktivitete në MEPJ.



Njësia e Katërt përgjigjet për sigurinë e brendshme të Presidencës, Kryeministrisë, Kryesisë së Kuvendit, Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Sallës së Seancave Plenare si dhe për ruajtjen e rendit dhe qetësisë gjatë zhvillimit të Seancave Plenare dhe gjatë mbledhjeve të Komisioneve Parlamentare. Gjithashtu ajo është përgjegjëse për sigurinë e objekteve të përkohshme (në Tiranë e rrethe) ku kryejnë aktivitetet PLSH-të e Vendit dhe të huaja.

Shërbimet për sektorët e kësaj njësie janë:

- Takime me Delegacione.
- Mbledhje Qeverie.
- Seanca Plenare.
- Mbledhje e Grupeve Parlamentare.
- Mbledhje komisionesh.
- Mbledhje ndërministrorë.
- Pritje të ndryshme në Seli (ceremoni dekorimi).
- Konferenca Shtypi.
- Vizitor, Punëtor.
- Shërbime përforcimi në Seli.



Njësia e Pestë është një strukturë e krijuar duke u bazuar në organikën e fundit të miratuar me VKM, për Gardën e Republikës. Kjo njësi është përgjegjëse për:



- Organizimin e shërbimit dhe ruajtjen e rezidencave.
- Rezidencave jashtë Tirane.
- Kontrollin për ruajtjen nga incidentet me LE, ASHM të mjeteve të PLSH-ve e PSH-ve të vendit dhe të huaja, të gjitha objekteve të përhershme e të përkohshme që ruhen nga Garda e Republikës.
- Kontrollin për ruajtjen nga incidentet me LE, ASHM të rrugëkalimeve të PLSH-ve të Vendit dhe të Huaja.

Spektori i Komunikimit dhe Elektronikës si pjesë përbërëse e Njësisë së Pestë, gjatë vitit 2020 ka realizuar objektivat si më poshtë vijon:

Është ngritur kapaciteti prej 36 TB në Servera për menaxhimin e informacionit në rrjetin kompjuterik të Gardës. Ka filluar puna për heqjen e materialeve nga kompjuterat personale dhe vendosjen e tyre sipas logimeve në Servera.

Janë përcaktuar politikat e administrimit të informacionit, rregullat për menaxhimin e incidenteve në rrjet si dhe politikat kufizuese në mbrojtje të informacionit.

Në bashkëpunim me AKSH-in, janë rifreskuar të gjitha licensat e rrjetit kompjuterik.

Aktualisht, në rrjetin e Gardës të gjithë kompjuterat dhe pajisjet janë me programe të liçensuara. Rrjeti është i routuar.

Ka vijuar puna për ngritjen e Serverit të Back Up-eve të Sektorit të Financës, duke marrë masat e nevojshme që të mos kemi ndërprerje të shërbimit, por dhe masa të larta sigurie.

Është përmirësuar rrjeti i vëzhgimit me kamera në venddislokimin "Pallati i Brigadave", si rezultat i punimeve të kryera në rrjet dhe pajisje.

Gjatë këtij viti, si rezultat i situatës COVID - 19, janë asistuar trajnimet e kryera online për punonjësit e Gardës.

Po konsolidohet sistemi GPS dhe i menaxhimit të karburantit dhe brenda muajit Dhjetor, do të migrojmë në një Platformë të re, më të sigurtë dhe me më shumë shërbime të reja.

Mbajtjen në gatishmëri të sistemit antidron dhe të pajisjes së antivalëve të telefonisë celulare (qendra mobile) dhe kryerjen e shërbimeve.

Kompletimin e strukturave të Gardës me armatim, municion dhe aksesore të tjerë, furnizimin ritmik të tyre.

Spektori i armatimit dhe pajisjeve gjatë vitit 2020 ka punuar për realizimin e detyrimit ligjor për kompletimin, ruajtjen, mirëmbajtjen e administrimit të armatimit, municionit dhe pajisjeve të tjera, detyrave që rrjedhin nga Programi i Veprimtarive Kryesore të Gardës.

Drejtimet kryesore në të cilat ky sektor ka përqëndruar punën për realizimin e synimit për vitin 2020 kanë qenë:


Realizimi i detyrimit ligjor për kompletimin me armatim, municion e pajisje të veçanta të strukturave të GRSH.

- Administrimi i vlerave materiale të armatimit.
- Kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes së armatimit e municionit.

Njësia Speciale përgjigjet për kryerjen e shërbimit mbështetës (grup CAT) për sigurinë e PLSH-ve të vendit dhe të huaja gjatë lëvizjeve në eskortë dhe gjatë evakuimit të tyre në rast situatave. Kjo njësi po ashtu është përgjegjëse për kryerjen e shërbimit mbështetës, përf forcimin e masave të sigurisë pranë ORV-ve në rastet e përshkallëzimit të situatave, organizimin dhe kryerjen e shërbimit kundërsnajper dhe shërbimit zhytës, si edhe për organizimin e kryerjen e shërbimit të sigurisë gjatë aktiviteteve në kushte të veçanta terreni e moti.

Kjo njësi gjatë vitit 2020 ka realizuar shërbime me Kryeministrin, shërbime me Delegacionet e Huaja, shërbime të përforuara.

Në asnjë rast nuk ka pasur cënime të masave të sigurisë.





1.2 SHËRBIMET MËSHTETËSE

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse përgjigjet për mbështetjen me transport, logjistikë dhe shërbim shëndetësor për të gjithë strukturat e Gardës.

Duke analizuar punën e kryer nga kjo Drejtori për vitin raportues, duhen analizuar komponentët përbërës të drejtorisë në fjalë që janë sektorët e saj. Në zbatim të VKM nr. 638 datë 29.07.2020 “Për trajtimin me ushqim pagë të punonjësve dhe kursantëve të Gardës së Republikës” me Urdhër nr. 1804 datë 08.09.2020, u ngrit grupi i punës me përfaqësues të GRSH dhe ISHP, për hartimin e projekt - normave të trajtimit me ushqim pa pagesë të punonjësve dhe kursantëve. Grupi i punës, përfundoi praktikën për miratimin e normave ushqimore, si:

Udhëzimi “Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim pa pagesë, për ditët efektive të punës, për punonjësit oficerë, nënoficerë dhe kursantë të Gardës së Republikës”, është dërguar për miratim në MB, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Është bërë furnizimi me artikuj të uniformës së Gardës për punonjësit oficer e nënoficer, të cilëve u ka lindur e drejta e rifurnizimit me uniformë. Gjithashtu janë kompensuar në vlerë lekë veshja civile për punonjësit oficerë e nënoficerë, që ju ka lindur e drejta e rifurnizimit gjatë këtij viti.

Është dërguar në MB projektvendimi i Kryeministrit, “Për disa shtesa e ndryshime në VKM Nr.136/2009 “Për miratimin e uniformës, gradave dhe shenjave dalluese të GR”.

Është ndjekur pranë ZVRPP, hipotekimi i pronave të Gardës së Republikës, sipas përcaktimeve në VKM nr.44 datë 25.01.2017; nr.156 datë 01.03.2017; nr.157 datë 01.03.2017. Janë marrë certifikatat për vërtetim pronësie për nëntë prona dhe janë në proces për pajisje me certifikatë dy prona, përkatësisht Sektori i Ruajtjes së Rezidencave dhe OKV Dajt dhe Sektori i Ruajtjes së Rezidencave Durrës.

Për pronën “Garnizoni” me numër pasurie 4/854, me vendodhjen në Zonën Kadestrale nr. 8270, në zbatim të VKM nr.406 datë 04.07.2018 dhe Urdhrit nr.170 datë 06.07.2020, të Ministrit të Brendshëm, është bërë dorëzimi i pjesës takuese të pronës, nga MB



(Garda e Republikës), te Ministria e Financave dhe Ekonomisë (Ndërmarrja Industriale nr.1, Tiranë) me Akt – dorëzimi nr.920 datë 20.07.2020 të Gardës së Republikës dhe nr. 265 datë 20.07.2020 të Ndërmarrjes Industriale Nr.1 Tiranë, si dhe dorëzimi i pjesës takuese të pronës, nga MB (Garda e Republikës) te Bashkia Tiranë (Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit), me Akt-dorëzimi nr.1842 datë 15.09.2020 të Gardës së Republikës dhe nr. 24830/1 datë 16.09.2020 të Bashkisë Tiranë. Për të gjithë procedurën, është njoftuar Sekretari i Përgjithshëm në MB.

Në zbatim të masave të kufizimit të përhapjes së Covid 19, janë kryer dezinfektime dhe higjienizime të herëpashershme të ambienteve të punës, automjeteve të PLSH-ve dhe PSH-ve. Sa i përket karburantit të mjeteve, është ndjekur realizimi i limiteve të karburantit dhe kilometrave për çdo mjet.

Janë realizuar detyrat për kompletim organik të mjeteve për kilometrat e përshkruar dhe mjetet e punës në shërbimet mbështetëse.

Janë zbatuar kriteret e përdorimit të mjeteve të përcaktuara me urdhra të veçantë, ku janë planizuar e realizuar kontrole sistematike në drejtim të shfrytëzimit të mjeteve, plotësimi të dokumentacionit të normuar, si autorizim lëvizje, fletë udhëtimi, parkimit të tyre, mirë administrimit të mjeteve etj.

Në zbatim të “Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” janë bërë pagesat e taksave për të gjitha automjetet në inventar të Gardës, ç’rregjistrimi i automjeteve të dala jashtë shfrytëzimit apo mbi numrin limit të miratuar për përdorim. Aktualisht nuk ka asnjë detyrim për mjetet në inventar përsa i përket taksave të automjeteve apo detyrime të prapambetura.

Pandemia Covid 19 ishte një sfidë e madhe në 2020. Në muajin Qershor u konstatua punonjësi i parë në Gardë i prekur me Covid 19. Gjatë vitit ka patur punonjës dhe që kanë qenë në gjendje më të rëndë dhe të shtruar në spitalet Covid 1 dhe 2. Fatkeqësisht, pavarësisht përpjekjeve të bluzave të bardha, ka patur dhe punonjës që kanë humbur jetën.

Të pakonfirmuar me tampon, por me shenja klinike, gjatë kësaj periudhe kanë qenë dhe shumë punonjës, të cilët janë karantinuar sipas protokolleve të shëndetësisë për një periudhë 14 ditore.



Që me shpërthimin e pandemisë, Sektori i Shëndetësisë në Gardë, çdo ditë ka ndjekur gjendjen shëndetësore të punonjësve. Bazuar në rekomandimet e ISHP, rregulloren TIP për marrjen e masave gjatë gjendjes së pandemisë Covid-19, është hartuar Plan masash për të ndjekur situatën gjatë gjithë kohës. Janë shpërndarë maska faciale e doreza për punonjësit, si masa anticovid.

Në Qendrën Shëndetësore të Gardës janë bërë vizita, mjekime e injeksione, ECHO, si dhe mjekime stomatologjike.

Gjatë këtij viti kemi patur dhe shtrime në spital të punonjësve. Të shtruarit në spitalin e Traumës apo në Qendrën Universitare Spitalore, janë ndjekur nga afër duke marrë kontakte të vazhdueshme me ta dhe me specialistët e shëndetësisë, duke ndjekur hap pas hapi ecurinë e tyre shëndetësore.

Në muajin Prill punonjësit e Gardës iu përgjigjen thirrjes së Kryqit të Kuq Shqiptar për të dhuruar gjak për njerëzit në nevojë dhe fëmijët talasemik. Dhuruan gjak 113 punonjës.

Në Arkivin e Gardës është bërë përpunimi i dokumentacionit sipas të gjitha kriterëve arkivore. Në këtë proces pune është bërë evidentimi, spontimi i dokumenteve me numrin e regjistrave të protokollit dhe indeksit alfabetik. Janë hartuar inventaret e dosjeve të Gardës së Republikës sipas të gjitha kriterëve arkivore të përcaktuara në rregulloren e Ministrisë së Brendshme Nr.1374 datë 26.11.2008.

Burimet Njerëzore

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është vlerësuar si thelbësor për Gardën e Republikës, sepse nënkupton përdorimin e drejtë dhe eficient të njerëzve për të kryer misionin e Institucionit. Është shumë e rëndësishme që punonjësit e sigurisë të kenë integritet të lartë, të jenë të besueshëm, korrekt, të përgjegjshëm dhe të kryejnë me devotshmëri çdo detyrë.

Proçesi i menaxhimit të burimeve njerëzore fillon që në fazën e rekrutimit të individëve, proces gjatë të cilit Garda zgjedh punonjësit e saj, duke u bazuar në aftësitë dhe përgatitjen e kandidatëve e duke vazhduar zhvillimin e tyre me anë të trajnimit.

Rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore ka të bëjë me përmirësimin e aftësive të individëve, me qëllim realizimin sa më eficient të detyrave të secilit.

Duke qenë një nga Sektorët më të rëndësishëm të Institucionit tonë, vëmendja maksimale edhe për këtë vit i është kushtuar resurseve të këtij sektori.

Sektori i Burimeve Njerëzore e ndërton punën bazuar në këto drejtime dhe objektiva kryesorë:

- Përmirësimi i sistemit të rekrutimit, qëndrimit në detyrë dhe promovimit, bazuar në sistemin e meritokracisë, vlerësimin objektiv e të qëndrueshëm si dhe trajnimin e vazhdueshëm profesional.
 - Sigurimi i një sistemi të drejtë, transparent dhe të barabartë për menaxhimin e karrierës lidhur me emërimin, vlerësimin dhe ecurinë në gradë e karrierë.
 - Përfundimi tërësor i një sistemi të automatizuar informacioni të menaxhimit të burimeve njerëzore, i cili të përdoret për të menaxhuar punonjësit në të gjitha nivelet.
- Viti 2020 për Sektorin e Burimeve Njerëzore ka qenë një vit me ngarkesë dhe detyra të ngjeshura, për shkak të dinamikës që dikton puna e përditshme, por edhe të futjes së elementëve të rinj në procesin e konkurimit për gradë e karrierë, përgatitjes dhe miratimit të akteve për ndryshimet strukturore që ndodhën për shkak të detyrave të reja që morëm si rezultat i krijimit të organeve të reja të drejtësisë dhe nevojës për masa sigurie ndaj drejtuesve të tyre.

Analizimi dhe reflektimi ndaj gjetjeve dhe detyrave të lëna nga auditi i Ministrisë dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka qenë një nga prioritetet e punës së sektorit gjatë vitit 2020.

Gjithashtu, u realizua shtrirja organike e strukturës dhe riemërimi i të gjithë punonjësve sipas VKM nr.572 datë 22.07.2020 deri në 22.08.2020. Këtij procesi i parapriu hapja e konkurimit për vendet e reja të punës, që u krijuan për oficerë dhe nënoficerë.

Ky proces u zhvillua në transparencë të plotë duke startuar me njoftimin e bërë në faqen e Ministrisë së Brendshme dhe të Gardës që në muajin Mars.

Në përfundim të procesit të konkurimit, u shpallën fituesit të cilët iu nënshtruan kursit të formimit të përgjithshëm.

Përfunduan brenda muajit Qershor 2020 kurset e kualifikimit për ecurinë në gradë e karrierë për të gjithë punonjësit oficer dhe nënoficer që iu kishte lindur e drejta për gradë, në Qendrën e Formimit dhe Kualifikimit Profesional.





Trajnimi i niveleve të larta drejtuese është bërë në bashkëpunim me Akademinë e Sigurisë, ku kanë kryer kurse për ecurinë në gradë për oficerë të nivelit të lartë në strukturë.

Komisioni i Gradave dhe Karrierës përmbylli procesin e konkurimit për punonjësit oficer e nënoficer.

Për vitin 2020 janë trajtuar me pension të plotë apo të parakohshëm për vjetërsi shërbimi ish punonjës dhe u janë kthyer përgjigje institucioneve të tjera për praktika pensionesh.

Qendra e Formimit dhe Kualifikimit Profesional

Stërvitja dhe kualifikimi i punonjësve për vitin 2020 kanë filluar sipas programit, por për shkak të masave për mbrojtjen nga infektimi nga virusi Covid-19, procesi mësimor me kurset e përparimit në gradë e karrierë për oficerët dhe nënoficerët u zhvillua sipas sistemit online. Në bazë të urdhrorit Nr. 481, datë 26.03.2020 “Për zhvillimin e procesit të mësimit në distancë, online, për kurset e përparimit në gradë e karrierë në Gardën e Republikës”, u morën të gjitha masat për përgatitjen e materialeve të studimit në formatin elektronik dhe shpërndarjen e tyre tek të gjithë punonjësit që morën pjesë në kurs. Gjatë kësaj periudhë u zhvilluan:

- Kursi për gradën e nivelit të mesëm për nënoficerët.
- Kursi i nivelit të lartë për nënoficerët.
- Kursi për gradën e nivelit të mesëm për oficerët.
- Kursi i nivelit të lartë për oficerët.

Duke zbatuar të gjitha masat e protokollit të vendosur për parandalimin e përhapjes së Covid 19, u organizua stërvitja me punonjësit e strukturave të GRSH.

Një tjetër **Sektor** i rëndësishëm i Gardës, por edhe i çdo institucioni në tërësi, është ai i **Financës** i cili ka realizuar të gjitha objektivat e vitit 2020. Treguesit e këtij Sektori rezultojnë të jenë positive, me gjithë ngarkesën e vitit që mbyllëm dhe kushtet e pazakonta të punës që shkaktoi pandemia globale.

Ndër objektivat kryesorë të Sektorit të Financës do të jetë që nëpërmjet mbështetjes me fonde të Programit, ky buxhetim të çojë në arritjen e objektivave të programit që janë:

Rritja e nivelit të sigurimit të PLSH dhe të ORV, modernizimin e infrastrukturës dhe mjeteve



që disponon Garda e Republikës në punën e saj të përditshme, duke synuar në rinovimin periodik të saj, me qëllimin final rritjen e shkallës së operacionalitetit të strukturës si dhe freskimi i rezervave të Emergjencës për të përmirësuar standartet e OKV.

Ndër rezultatet e pritshme në kuadër të objektivave mund të përmendim rritjen e nivelit të sigurisë së personaliteve në punë e rezidenca nëpërmjet trajtimit sa më të plotë financiar të punonjësve që i shërbejnë këtij qëllimi dhe përmirësimi në mënyrë të vazhdueshme të infrastrukturave në përdorim të Gardës së Republikës.





KAPITULLI III

AKTE TË MIRATUARA

Infrastruktura Ligjore dhe akte normative të miratuara gjatë vitit 2020:

- Udhëzim Nr.180, datë 24.01.2020 “Për plotësimin e treguesve të punës në strukturat e Gardës së Republikës për vitin 2020”.
- Urdhër Nr. 182, datë 27.01.2020, “Për krijimin dhe funksionimin e komisionit të shqyrtimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në Gardën e Republikës”.
- Urdhër Nr. 200, datë 30.01.2020 “Për zhvillimin e testimit të kandidatëve që do të trajnohen për shërbimet e sigurisë fizike të PLSH-ve”.
- Urdhër Nr. 375, datë 25.02.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për studimin dhe rikonceptimin e masave të ruajtjes së objekteve të Gardës së Republikës”.
- Urdhër Nr. 423, datë 03.03.2020 “Për zhvillimin e kursit për përparim në gradë e karrierë për nënoficerët për gradat e nivelit të mesëm”.
- Urdhër Nr. 438, datë 05.03.2020 “Për zhvillimin e kursit për përparim në gradë e karrierë për oficerët për gradat e nivelit të mesëm”.
- Letër porosi Nr. 452, datë 10.03.2020 “Për marrjen e masave për një menaxhim sa më të mirë të situatës për shkak të përhapjes së virusit COVID-19.”
- Plan masash Nr.452/1, datë 11.03.2020 “Plan i masave organizative, administrative, të strukturave të Gardës së Republikës për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19”.
- Urdhër Nr. 481, datë 26.03.2020 “Për zhvillimin e procesit të mësimin në distancë (online) për kurset e përparimit në gradë e karrierë në Gardën e Republikës”.
- Urdhër Nr. 567, datë 06.05.2020 “Për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2020”.
- Urdhër Nr. 662, datë 05.06.2020 “Për ngritjen e komisionit të ekspertizës”
- Urdhër Nr. 676, datë 09.06.2020 “Për zhvillimin e testimit të punonjësve oficerë e nënoficerë që kanë kryer kursin për përparim në gradë e karrierë në periudhën mars-maj 2020”.
- Urdhër Nr. 647, datë 01.06.2020 “Për zhvillimin e testimit të kandidatëve për punësim në strukturat e Gardës së Republikës”.
- Urdhër Nr. 627, datë 27.05.2020, “Për zhvillimin e kursit të formimit profesional për nënoficerë, për shërbimet në strukturat e Gardës së Republikës”.



- Udhëzim Nr. 391/3, datë 30.06.2020 "Mbi procedurat e zhvillimit të testimit në proçesin e konkurrimit për gradë e karrierë".
- Urdhër Nr. 814 datë 08.07.2020 "Për zhvillimin e kursit të formimit të përgjithshëm për nënoficerë, për shërbimet në strukturat e Gardës së Republikës".
- Urdhër Nr. 820 datë 09.07.2020 "Për disa ndryshime në Urdhrin Nr. 3737 datë 15.10.2018 "Për shtimin e masave të sigurisë për Kryeministrin e vendit dhe Familjen e tij".
- Urdhër Nr. 919, datë 20.07.2020 "Për zhvillimin e proçesit të konkurimit për gradë dhe karrierë, për punonjësit nënoficerë, në Gardën e Republikës, për vitin 2020".
- Urdhër Nr. 991 datë 22.07.2020 "Për miratimin e manualit të etikës së Gardës së Republikës".
- Urdhër Nr. 2418 datë 27.10.2020 "Për inventarizimin dhe vlerësimin për nxjerrjen nga përdorimi të aktiveve në inventar të Gardës së Republikës".
- Urdhër Nr. 2573 datë 27.11.2020" Për zhvillimin e kursit të përgatitjes profesionale për oficerë në strukturat e Gardës së Republikës"

Ndër aktet ligjore të rëndësishme të miratuara gjatë vitit 2020 që vlen të përmendet është Manuali i Etikës së punonjësit të Gardës, miratuar me Urdhër Nr. 991 datë 22.07.2020 "Për miratimin e manualit të etikës së Gardës së Republikës".

Një tjetër akt nënligjor i miratuar në kuadër të mirëfunksionimit dhe organizimit të GRSH, ishte edhe Strategjia e Gardës 2020 - 2030, miratuar me Urdhër nr 1846/1 datë 17.09.2020 "Për hartimin e dokumentit "Strategjia e Gardës së Republikës" 2020-2030".

Projekti më i rëndësishëm për Gardën për vitin 2020 padiskutim mbetet hartimi i projektligjit "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë".

Qëllimi i këtij projektligji është reformimi i Gardës së Republikës duke i dhënë një frymë të re bashkëkohore. Ky projektligj synon të përmirësojë veprimtarinë e Gardës së Republikës në tërësi dhe përafrimin e saj me institucionet homologe. Ky projektligj ka parashikuar, ndër të tjera, si objektiv të reformës së tij, riorganizimin në tërësi të Gardës, duke përafruar statusin e punonjësit të këtij shërbimi me atë të punonjësit të Policisë së Shtetit, por njëkohësisht duke ruajtur misionin.

Hartimi i këtij projektligji është një domosdoshmëri e kohës.

Periudha mbi pesëmbëdhjetëvjeçare që ka kaluar nga ligji i cili aktualisht është në fuqi dhe problematikat që ka diktuar dinamika e punës, kanë bërë të nevojshëm hartimin e këtij projektligji, me synim për t'ia përshtatur situatës aktuale.



KAPITULLI IV

OBJEKTIVA PËR VITIN 2021

Garda e përqëndron veprimtarinë e saj në realizimin e misionit e objektivave për sigurinë e **Personaliteteve** të Larta Shtetërore dhe Ruajtjes së Objekteve të Rëndësisë së Veçantë. Ajo mbështetet në legjislacionin në fuqi, orientimet e Ministrisë, programin e veprimtarive vjetore dhe planifikimin e detyrave mujore, si dhe zbaton praktikatat e punës për secilin sektor.

Plani vjetor i Gardës së Republikës dhe Strategjia e Institucionit përcaktojnë prioritetet kryesore të Gardës për vitin. Këto dokumente detajojnë punët që do të kryhen gjatë vitit, duke përkrahur punët rutinë dhe ato të reja të planifikuara në kuadër të përmbushjes së misionit, gjithmonë me qëllim përafrimin e standardeve me ato të BE.

Prioriteti kryesor është dhe do të vijojë të jetë edhe për vitin 2021: siguria e jetës së personaliteteve, si dhe objekteve e mjediseve të punës, të banimit, të akomodimit, shoqërimit e sigurisë në rrugëkalime, në shërbime të hapura e të mbyllura, me qëllimin që të prandalohet në kohë jo vetëm çdo akt i mundshëm me tendencë kriminale, por edhe çdo veprim tjetër sado i dhunshëm apo pengues në lëvizjen normale dhe ushtrimin e detyrës së personalitetit.

Për vitin 2021 Garda synon të rrisë efikasitetin e saj në disa drejtime kryesore. Për këtë qëllim janë hartuar dhe synohen të përmbushen objektiva të mirëorganizuar nga çdo strukturë, pjesë përbërëse e Institucionit.

1. Rritja e nivelit të sigurisë së Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe Objekteve të Rëndësisë së veçantë në ruajtje.

Çfarë synohet të arrihet: Modernizimi i pajisjeve dhe mjeteve që Garda përdor për përmbushjen e detyrave në shërbimet e sigurisë.



Masat konkrete:

- Hartimi i planeve të reja të bashkëpunimit ndërmjet Gardës dhe Shërbimit Informativ Shtetëror, Policisë së Shtetit dhe insitucioneve të tjera ligjzbatuese për shkëmbimin në kohë të informacioneve në lidhje me masat e sigurisë për PLSH dhe ORV.
- Blerje armatimi të ri.
- Blerje pajisje për LE dhe ASHM.
- Blerje automjete të reja.

Ndikimi i impaktit: Përmbushja e këtij prioriteti i cili lidhet me financimet sjell impakt në përmirësimin e cilësisë në zbatimin e detyrës.

2. *Përmirësimi i procesit të menaxhimit në Gardën e Republikës*

Synimi:

- Përmirësim i treguesve të performancës.
- Inkorporimi i modelit të vetëvlerësimit.
- Përmirësimi i elementeve në infrastrukturën dhe teknologjinë e sektorit të Burimeve Njerëzore.
- Transformimi i metodologjisë së arsimit në bashkëpunim me Akademinë e Policisë dhe atij trajnues në strukturat tona, për të siguruar programe të integrueshme dhe gjithëpërfshirëse, të cilat do të përgatitin kandidatët për oficerë në Gardë, si dhe të gjithë personelin për specialitetet e nevojshme.

Masat konkrete:

- Hartimi dhe miratimi i modelit të ri të vlerësimit të punonjësve të Gardës.
- Ndërtimi i një database qendrore për menaxhimin e kartotekës online.
- Arsimi bazë dhe trajnime të tjera do të kryhen në Akademinë Sigurisë.
- Synohet një rritje e bashkëpunimit në kuadër të stërvitjes dhe përmirësimit të nivelit të sigurisë së personaliteteve duke bashkëpunuar me struktura ndërkombëtare homologe. Vijim i bashkëpunimit me Karabinierinë Italiane dhe Xhandarmërinë Turke për shkëmbim eksperiencash.
- Inkorporimi i procedurës së re për procesin e konkurrimit për gradë dhe karrierë të punonjësve.

Ndikimi i impaktit: Përmbushja e këtij prioriteti i cili lidhet me financimet sjell impakt në përmirësimin e cilësisë së sigurisë së personaliteteve

4. Përmirësim i kualifikimeve dhe trajnimeve

Synimi:

Rritje e nivelit të përgatitjes profesionale dhe fizike të punonjësve, zhvillimi i stërvitjes në kushte sa më të përafërta me detyrat që kryen punonjësi, e cila lidhet drejtpërdrejtë edhe me rritjen e cilësisë së shërbimeve të kryera prej tyre.

Masat konkrete

- Hartimi i planit dhe kryerja e kurseve të kualifikimit për ecurinë në gradë e karrierë për punonjësit oficer dhe nënoficer për vitin 2021.
- Hartimi i planit dhe kryerja e kurseve të kualifikimit për shërbimet e sigurisë dhe ruajtjes direkte të personalitetit (oficer, nënoficer sigurie).
- Hartimi i planit dhe kryerja e kurseve të kualifikimit për specialitete të veçanta.
- Hartimi i planeve të bashkërenduar me Akademinë e Sigurisë për kualifikimin e punonjësve oficer për përparim në gradë e karrierë, për gradat e nivelit të lartë dhe kualifikimi i punonjësve me arsim të lartë jopolicor.
- Përmirësimi i mëtejshëm i programeve e kurrikulave, me synim profilizimin e tyre në përputhje me detyrat funksionale dhe veçorive të shërbimit të strukturave, duke ruajtur standartet e institucioneve të tjera arsimore që operojnë në fushën e sigurisë.
- Rritja e mëtejshme e aftësive profesionale të punonjësve të strukturave të Gardës, për kryerjen e detyrave sipas natyrës së shërbimit dhe nivelit të Gradës.
- Pjesëmarrje në stërvitjet e përbashkëta me Policinë e Shtetit.

Ndikimi i impaktit: Përgatitja profesionale e punonjësve të Gardës së Republikës për kryerjen e misionit të saj.

4. Përmirësim i kuadrit ligjor dhe nën ligjor të Gardës

Synimi: Miratimi i projektligjit “Për Gardën e Republikës” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.



Masat konkrete: Propozimi i projektvendimeve:

- Për përcaktimin e objekteve që ruan dhe mbron Garda e Republikës.
- Për miratimin e Strukturës organike dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve të Gardës së Republikës dhe përcaktimin e gradës korresponduese për funksion.
- Për përcaktimin e personaliteteve shtetërore dhe banesave të tyre që ruhen nga Garda e Republikës dhe kohëzgjatja e ruajtjes.
- Për përcaktimin e procedurave për transferimin e punonjësit të Gardës së Republikës në struktura të tjera të Ministrisë së Brendshme;
- Për trajtimin financiar të punonjësve të Gardës së Republikës gjatë marrëdhënieve të punës;
- Për përfitimin e sigurimit shëndetësor të veçantë dhe sigurimin e jetës për punonjësin e Gardës së Republikës.
- Për përfitimin e kredisë me interesa të butë dhe kompesimit për strehim për punonjësit e Gardës së Republikës.
- Për trajtimin financiar të familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës.
- Për përcaktimin e simboleve, uniformës, shenjave dalluese dhe normave të veshmbathjes të punonjësve të Gardës së Republikës.
- Për përcaktimin e llojit të armatimit, të lëndëve neuroparalizuese, të mjeteve e paisjeve të tjera kufizuese për përdorimin e forcës nga Garda e Republikës.
- Për miratimin e Rregullores së Gardës së Republikës.

Ndikimi i impaktit: Miratimi i projektligjit dhe i këtyre projektakteve ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e veprimtarisë së Gardës dhe të marrëdhënieve të punës së punonjësve.



KAPITULLI V

KONKLUZIONE

Gjatë vitit 2020, strukturat e Gardës kanë përballuar me sukses kryerjen e detyrave të sigurisë edhe gjatë situatës së pazakontë të shkaktuar nga virusi Covid 19, çka solli edhe vështirësi në kryerjen e shërbimeve duke patur parasysh përgjegjësinë që ka secili punonjës i sigurisë që shërben pranë personaliteteve.

Në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar me ligj, Garda e Republikës ka bashkëpunuar ngushtë për kryerjen e detyrave me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Protokollin e Shtetit dhe institucioneve, administratën e institucioneve, SHISH, Agjensinë Inteligjente të Sigurisë së Mbrojtjes, Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Tiranë, SHÇBA- në Ministrinë e Brendshme, Drejtoritë Vendorë të Policisë në qarqe dhe me Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, etj.

Treguesit e performancës të punonjësve të Gardës së Republikës kanë rritje të efektivitetit në kryerjen e misionit. Po ashtu, miratimi i tre VKM-ve, të cilat vlerësojnë figurën e punonjësit të Gardës edhe më tepër, janë një motivim që secili prej nesh të japë më të mirën në punën e tij të ngarkuar prej ligjit.

Për realizimin e konkurrencës së aplikantëve që dëshirojnë të bëhen pjesë e Gardës së Republikës si punonjës oficerë dhe nënoficerë, është hapur një proces tërësisht transparent në faqen zyrtare të Gardës për publikun. Kjo, në kuadër edhe të rritjes së imazhit dhe besueshmërisë së Institucionit karshi qytetarëve.

Nisur nga fakti i rëndësishëm se Shqipëria po realizon gjithnjë e më tepër objektivin e të qenit pjesë e familjes së Bashkimit Europian, para Gardës së Republikës shtrohet si i domosdoshëm kontributi dhe roli i saj në krijimin e një imazhi të një shteti me siguri të lartë. Përpos këtij fakti, rezultojnë po ashtu i rëndësishëm roli i Shqipërisë në arenën ndërkombëtare si vend i renditur krahas atyre në luftën kundër terrorizmit.

Këtë e vlerësojmë si shtysë për të bërë të mundur përmirësimin e vazhdueshëm të masave të sigurisë në zbulimin dhe parandalimin e çdo rreziku të mundshëm, që mund të çenojnë misionin e Gardës, në mënyrë të tillë që të ruajmë klimën e qetësisë dhe sigurisë kombëtare.

Garda e Republikës do jetë gjithnjë e gatshme për të punuar me përkushtim që objektivat t'i përmbushë me sukses.



GARDA E REPUBLIKËS